

Vendim nr. 206, datë 18.06.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Genti Ibrahim, Anëtar

Illir Toska, Anëtar

në datën 18.06.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 4 (J) 2026 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: JEHONA ZHUKA

OBJEKTI: Anulimi i ligjit nr. 10289, datë 17.06.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, pasi nuk përfshin shpërblimin e fëmijëve të punonjësve të policisë të cilët aksidentohen për vdekje në punë dhe të cilëve ua njeh Instituti i Sigurimeve Shoqërore aksident në punë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, 33, 35, 42, 49, 57, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokolli shtesë i saj; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës

**Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (Ligji
Organik i Gjykatës).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjo i relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën dhe dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Jehona Zhuka është bashkëshortja e të ndjerit G.Zh., i cili ka qenë punonjës i Policisë së Shtetit, me detyrë “përgjegjës turni” në pikën e kalimit kufitar të Hanit të Hotit, Shkodër. Në datën 16.06.2023, pas përfundimit të shërbimit, ndërsa po kthehej nga Shkodra në banesën e tij në Tiranë dhe drejtonte automjetin personal në aksin rrugor Balldre-Lezhë, ai është përfshirë në një aksident rrugor, si pasojë e të cilit ka humbur jetën. I ndjeri G.Zh. ka lënë pas bashkëshorten dhe dy fëmijë.

2. Ligji nr. 108, datë 31.07.2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar (*ligji nr. 108/2014*), në fuqi në kohën e ndodhjes së aksidentit, në nenin 75 të tij rregullonte trajtimin e familjarëve të punonjësve të rënë për shkak të detyrës dhe përfitimet e tyre. Ky ligj është shfuqizuar me ligjin nr. 82, datë 26.07.2024 “Për Policinë e Shtetit” (*ligji nr. 82/2024*), i cili, në nenin 111 të tij, rregullon trajtimin e familjarëve të punonjësve që humbin jetën për shkak të detyrës. Sipas pikës 2 të këtij neni, rregullat dhe procedurat e trajtimit të familjarëve të punonjësve që humbin jetën për shkak të detyrës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Për sa i përket kuadrit ligjor në fuqi për trajtimin ekonomik dhe financiar të familjarëve të punonjësve që humbin jetën për shkak të detyrës, ligji nr. 10289, datë 17.06.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës” (*ligji nr. 10289/2010*) parashikon të drejtën e familjarëve për të përfituar si vijon: pension familjar për fëmijët, në masë të barabartë me pagën referuese në çastin e humbjes së jetës, deri kur secili të ketë mbushur moshën 18 vjeç dhe, pas kësaj periudhe, pension familjar e suplementar për

bashkëshorten/bashkëshortin dhe anëtarët e familjes në ngarkim (neni 2); ndihmë të menjëhershme financiare jo më pak se 200.000 lekë për bashkëshorten/bashkëshortin, fëmijët nën 18 vjeç ose deri në 25 vjeç, kur kryejnë studimet e larta, prindërit bashkëjetues dhe personat në kujdestari (neni 3); ndihmë të menjëhershme për përballimin e shpenzimeve të varrimit (neni 4); bursë të plotë për fëmijët që kanë fituar të drejtën e ndjekjes së studimeve në institucionet publike shtetërore të arsimit të lartë brenda vendit (neni 5); trajtim me përparësi për strehim (neni 6); shpërblim deri në masën e një page mujore të gradës më të lartë të nivelit zbatues në ditën përkujtimore (neni 7). Sipas nenit 8 të këtij ligji, Këshilli i Ministrave nxjerr aktet nënligjore në zbatim të tij dhe përcakton masën, kriteret dhe procedurat për dhënien e ndihmës, si dhe për trajtimin ekonomik e financiar.

4. Në datën 16.02.2025 shtetasi Sh.Zh., babai i të ndjerit G.Zh., i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin e ligjit nr. 82/2024. Për këtë kërkesë, Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 94, datë 15.04.2025, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, pasi ka vlerësuar se kërkuuesi nuk legjitimohej *ratione personae*.

5. Në datën 12.05.2025 kërkuuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e ligjit nr. 82/2024, për shkak se nuk përfshin në rrethin e përfituesve fëmijët nën moshën 18 vjeç të punonjësve të Policisë së Shtetit që humbin jetën si pasojë e një aksidenti në punë, të njohur si i tillë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore (*ISSH*). Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës, me vendimin nr. 187, datë 15.07.2025 (*vendimi nr. 187/2025*), ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, duke arritur në përfundimin se nuk plotësohej kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

6. Në datën 13.10.2025 komisioni “Për trajtimin e familjarëve të punonjësve të Policisë së Shtetit të vrarë ose plagosur në krye ose për shkak të detyrës”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (*DPPSH*), pasi ka rishqyrtuar dokumentacionin, ka vendosur se shtetasi G.Zh., bashkëshorti i kërkueses, nuk plotëson kriteret për t’u trajtuar si punonjës i rënë “në krye apo për shkak të detyrës”.

7. Në datën 03.11.2025 kërkuuesja i është drejtuar sërish Gjykatës me ankim kushtetues individual për kundërshtimin e ligjit nr. 82/2024. Për këtë ankim, Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 25, datë 23.01.2026, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Në datën 27.02.2026 kërkuuesja ka paraqitur ankim kushtetues me të njëjtin objekt dhe për të njëjtat shkaqe, për të cilin Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 143, datë 06.05.2026, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, bazuar në nenin 31/a, pika 2, shkronja “dh”,

të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi nuk ka konstatuar ndonjë rrethanë faktike ose juridike të re në lidhje me objektin dhe shkakun e kërkesës dhe as ndonjë argument shtesë që të justifikonte rishqyrtimin e çështjes.

8. Në datën 30.03.2026 kërkesja i është drejtuar sërish Gjykatës me ankim kushtetues individual, me objekt anulimin e ligjit nr. 10289/2010. Ky ankim, pasi është plotësuar sipas kërkesave të nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 30.04.2026.

II

Pretendimet e kërkuases

9. **Kërkesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se bashkëshorti i saj ka humbur jetën pas përfundimit të shërbimit, ndërsa po kthehej në banesë, pas 20 orësh punë. Ky aksident nuk do të kishte ndodhur nëse shteti do t'i kishte siguruar transport. Ai ka lënë pas dy fëmijë, të moshës 12 dhe 16 vjeç, ndërsa fëmija më i madh ka nevoja të veçanta për shkak të autizmit. Kërkesja nuk ka as biznes, as tokë, ndërsa ka punuar në një çerdhe shtetërore, ku përfitonte pagën prej 37.000 lekësh në muaj. Fëmijëve u është caktuar një pension familjar minimal, pasi paga e bashkëshortit në kohën e humbjes së jetës ishte e ulët, ndërkohë që rritja e pagave dhe ngritja e tij në gradë do të hynin në fuqi më 1 korrik. Në bazë të nenit 2, shkronja “d”, të VKM-së nr. 788, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e aksidentit në punë ose për shkak të punës”, ngjarja në të cilën ka humbur jetën bashkëshorti i kërkuases është njohur si “aksident në punë” edhe me vendim të drejtorit të ISSH-së. Kërkesja ka aplikuar edhe pranë komisionit përkatës në DPPSH për të përfituar në bazë të pikës 3 të udhëzimit nr. 6, datë 21.10.2010, por i është kthyer përgjigje se familjarëve nuk u takon trajtim dhe shpërblim financiar, pasi bashkëshorti i saj nuk është vrarë me armë. Sipas kërkuases, Gjykata duhet të plotësojë ligjin e kundërshtuar, në mënyrë që në rrethin e përfituesve të përfshihen edhe familjarët e punonjësve të Policisë së Shtetit që humbin jetën si pasojë e një aksidenti në punë, të njohur si i tillë nga ISSH-ja dhe, mbi këtë bazë, kërkuases dhe fëmijëve të të ndjerit t'u jepet ndihma e menjëhershme financiare në masën 200.000 lekë për secilin. Aktualisht, kërkesja ndodhet në Belgjikë me djalin e saj për kurimin e tij në një klinikë të specializuar, dhe jeton në një dhomë me qira. Ajo ka lënë punën në Shqipëri dhe është në gjendje të vështirë ekonomike.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkueses

10. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private ose publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

11. Kur objekt i ankimit kushtetues individual është shfuqizimi i ligjit ose aktit normativ, bazuar në nenet 49, pika 3, shkronja “e” dhe 71, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës, kërkuesi legjitimohet nëse plotëson bashkërisht këto kritere: (i) legjitimimi *ratione personae*, në kuptimin që individi provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar, si dhe provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese; (ii) shterimi i mjeteve juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose individi provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm; (iii) legjitimimi *ratione temporis*, në kuptimin që individi ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit; (iv) legjitimimi *ratione materiae*, në kuptimin që individi provon se pretendimet e ngritura janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, pra të drejtat dhe liritë themelore që pretendohen se janë cenuar janë të garantuara në Kushtetutë, si dhe shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur (*shih vendimet nr. 34, datë 12.06.2023; nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, ndaj mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kritereve të legjitimitetit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuenin. Po kështu, mospërmbyshja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së tyre, me pasojë moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kritereve të tjera. Mbi këtë bazë, Kolegji, në vijim, do të ndalet vetëm në verifikimin e kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*.

13. Kolegji, bazuar në aktet bashkëlidhur ankimit kushtetues, vëren se kërkuësja është bashkëshortja e punonjësit të ndjerë të Policisë së Shtetit, G.Zh., i cili ka humbur jetën në vitin

2023 në një aksident rrugor, pas përfundimit të shërbimit, ndërsa po kthehej në banesën e tij në Tiranë. I ndjeri ka lënë pas edhe dy fëmijë të mitur, përkatësisht të moshës 12 vjeç dhe 16 vjeç. Po ashtu, nga aktet bashkëlidhur ankimit kushtetues nuk rezulton se familjarët e të ndjerit kanë përfituar trajtim sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014, në fuqi në kohën e ndodhjes së ngjarjes, ose të ligjit nr. 82/2024, të cilat përmbajnë parashikime të njëjta lidhur me trajtimin e familjarëve të punonjësve të policisë që humbin jetën për shkak të detyrës. Gjithashtu, sipas akteve bashkëlidhur ankimit kushtetues, në datën 13.10.2025 komisioni “Për trajtimin e familjarëve të punonjësve të Policisë së Shtetit të vrarë ose plagosur në krye ose për shkak të detyrës”, në DPPSH, pas rishqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, ka vendosur se shtetasi G.Zh., bashkëshorti i kërkueses, nuk plotësonte kriteret për t’u trajtuar si punonjës i rënë “në krye apo për shkak të detyrës”, pasi ka humbur jetën në një aksident rrugor pas përfundimit të shërbimit.

14. Pas ankimeve kushtetuese për kundërshtimin e ligjit nr. 82/2024, kërkuësja, për të njëjtat shkaqe, ka kundërshtuar edhe ligjin nr. 10289/2010, objekt të kërkesës në shqyrtim, duke kërkuar, në thelb, plotësimin e ligjit të kundërshtuar, në mënyrë që në rrethin e përfituesve të përfshihen edhe familjarët e punonjësve të Policisë së Shtetit që humbin jetën si pasojë e një aksidenti në punë, të njohur si i tillë nga ISSH-ja, dhe atyre t’u jepet ndihma e menjëhershme financiare e parashikuar nga ligji. Kolegji vëren se si ligji nr. 10289/2010, ashtu edhe ligji nr. 82/2024 parashikojnë trajtimin ekonomik e financiar të familjarëve të punonjësve të Policisë së Shtetit që humbin jetën në krye të detyrës ose për shkak të saj. Ndërkohë, kërkueses dhe fëmijëve të saj nuk u është njohur cilësia e subjekteve përfituese, pasi komisioni përkatës i ngritur në DPPSH ka vlerësuar se i ndjeri G.Zh., në kuptim të këtyre akteve ligjore, nuk ka humbur jetën në krye të detyrës ose për shkak të saj. Po kështu, realizimi i përfitimeve të parashikuara nga këto ligje nuk rrjedh drejtpërdrejt nga norma ligjore, por kërkon vlerësimin e organit kompetent dhe nxjerrjen e aktit administrativ individual përkatës. Për rrjedhojë, ligji i kundërshtuar nuk është drejtpërdrejt i zbatueshëm në rastin e kërkueses.

15. Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës, në shqyrtimin e ankimit kushtetues për kundërshtimin e ligjit nr. 82/2024, ka vlerësuar se kërkuësja, edhe pse ka pretenduar se u është drejtuar strukturave të DPPSH-së, nuk ka paraqitur asnjë akt të organit administrativ për mënyrën e zbatimit të ligjit të mëparshëm dhe të ligjit në fuqi, objekt ankimi. Mbledhja e Gjyqtarëve ka vlerësuar se, në kushtet kur për zbatimin e ligjit të kundërshtuar nevojitet nxjerrja e akteve administrative nga organet përgjegjëse, kërkuësja nuk kishte parashtruar dhe argumentuar nëse

bashkëshortit të ndjerë i ishte njohur ose refuzuar statusi i “të rënit në detyrë”, pra nuk kishte paraqitur një akt administrativ individual me pasoja negative dhe, në vijim, nëse kishte pasur ose jo mjete juridike në dispozicion për kundërshtimin e tij apo nëse këto mjete ishin joefektive (*shih vendimin nr. 187, datë 15.07.2025 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës*).

16. Pas vendimit të Mbledhjes së Gjyqtarëve, komisioni kompetent në DPPSH ka rishqyrtuar dokumentacionin për shtetasin G.Zh. dhe me vendimin e datës 13.10.2025 ka arritur në përfundimin se ai nuk plotësonte kriteret ligjore për t’u trajtuar si punonjës i rënë në krye ose për shkak të detyrës. Për rrjedhojë, familjarëve të tij nuk u është njohur e drejta për të përfituar trajtimin ekonomik dhe financiar të parashikuar nga ligji. Kërkuesja, pavarësisht se është pajisur me një akt administrativ të organit kompetent, i cili ka sjellë pasoja të drejtpërdrejta për të dhe fëmijët e saj, nuk e ka kundërshtuar atë në rrugë gjyqësore. Përkundrazi, ajo dhe i ati i të ndjerit u janë drejtuar organeve administrative dhe Avokatit të Popullit, si dhe ministrisë dhe deputetëve për ndërmarrjen e nismave ligjore. Po ashtu, ata i janë drejtuar në mënyrë të përsëritur Gjykatës, duke kundërshtuar aktet ligjore të mësipërme, për shkak se nuk parashikojnë trajtim financiar edhe për familjarët e punonjësve të Policisë së Shtetit që humbin jetën si pasojë e një aksidenti të njohur si aksident në punë nga ISSH-ja. Këto kërkesa dhe ankime, megjithatë, nuk zëvendësojnë kundërshtimin gjyqësor të aktit administrativ individual të datës 13.10.2025.

17. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se kërkuesja, përpara se të vinte në lëvizje gjykimin kushtetues, duhej të kundërshtonte në rrugë gjyqësore aktin administrativ individual me pasoja negative. Në këtë mënyrë, në përputhje me parimin e subsidiaritetit, gjykatave të juridiksionit të zakonshtëm do t’u jepej mundësia të vlerësonin ligjshmërinë e aktit administrativ dhe të kontrollonin mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të dispozitave ligjore nga organi publik. Ky mjet juridik nuk rezulton të jetë formal ose haptazi joefektiv, pasi gjykatat kompetente mund të kontrollojnë ligjshmërinë e aktit administrativ, të interpretojnë dispozitat e zbatueshme në përputhje me Kushtetutën dhe, nëse çmojnë se ligji i zbatueshëm vjen në kundërshtim me të, të vënë në lëvizje kontrollin incidental të kushtetutshmërisë sipas nenit 145, pika 2, të Kushtetutës. Vetëm pas shterimit të këtyre mjeteve sipas rregullave procedurale të zbatueshme, kërkuesja mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual. Kërkuesja, nga ana e saj, nuk ka pretenduar se ka paraqitur padi për kundërshtimin e aktit të datës 13.10.2025, nuk ka treguar se ekziston ndonjë proces gjyqësor në zhvillim dhe as ka parashtruar argumente që të provojnë se mjetet

juridike të parashikuara nga legjislacioni në fuqi do të ishin joefektive në rrethanat konkrete të çështjes.

18. Kolegji çmon të theksojë edhe se, ashtu sikundër është vlerësuar nga Mbledhja e Gjyqtarëve në vendimin e saj nr. 187/2025, *prima facie*, fusha e zbatimit e ligjit të kundërshtuar nr. 10289/2010, sipas interpretimit të organit administrativ, nuk e përfshin rastin e kërkueses dhe, për rrjedhojë, mund të prekë interesat e pretenduara prej saj dhe fëmijëve të mitur. Megjithatë, fakti që kërkuessa e paraqet pretendimin e saj si nevojë për plotësimin e ligjit nuk e përjashton detyrimin për shterimin e mjeteve juridike efektive dhe, në veçanti, për kundërshtimin paraprak të aktit administrativ individual, me qëllim që gjykatat e juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë nëse rasti konkret mund të përfshihet në fushën e zbatimit të dispozitave ekzistuese. Organi administrativ kompetent tashmë është shprehur për zbatimin e ligjit në rastin konkret përmes aktit të datës 13.10.2025. Për rrjedhojë, u takon në radhë të parë gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të kontrollojnë ligjshmërinë e këtij akti dhe të interpretojnë e zbatojnë dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, duke mbajtur parasysh qëllimin e tyre, marrëdhënien ndërmjet nocionit “aksident në punë” dhe kriterit ligjor të humbjes së jetës “në krye ose për shkak të detyrës”, si dhe rrethanat konkrete të ngjarjes. Në përputhje me natyrën subsidiare të gjykimit kushtetues, Gjykata nuk mund të zëvendësojë gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në ushtrimin e kompetencave të tyre dhe as të shprehet përpara se ato të kenë kontrolluar interpretimin dhe zbatimin e normave ligjore në rrethanat konkrete të çështjes. Po kështu, edhe nëse, pas shterimit të mjeteve juridike, mungesa e pretenduar e një rregullimi të tillë do të ngrinte një çështje kushtetuese, Gjykata nuk mund të zëvendësojë ligjvënësin duke hartuar vetë një dispozitë të re, duke përcaktuar një kategori të re përfituesish ose masën e përfitimit financiar, pasi përmbajtja konkrete e një rregullimi të tillë i përket ligjvënësit.

19. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se kërkuessa nuk plotëson kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar.

20. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkueses nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.